



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (*komision për dhënie mendimi*).
2. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për arsimin profesional (*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Fatmir Velaj, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Lindita Nikolla - Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Mirela Bimo - drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në MASR,
Florian Nurçe - përgjegjës në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në MASR,
Maringlen Mërtiri - këshilltar në Kabinetin e ministres, në MASR,

Jetlir Gjergji - drejtor i Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në MASR,
Gentian Opre - drejtor për Buxhetin në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Fillojmë mbledhjen e radhë së komisionit!

Sot jemi mbledhur për të diskutuar në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”. Kemi ftuar në komision përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës, për arsimin profesional.

Është e pranishme sot këtu zonja Lindita Nikolla, ministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, e shoqëruar nga stafi i saj.

Nga Ministria e Financave kemi ftuar zotin Gentian Opre, drejtor për buxhetin në MEF.

Para se të fillojmë, unë desha t’i jap fjalën zotit Ylli për të bërë një konfirmim të kuorunit që kemi në komision.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë, por mua më vjen keq që, për një çështje kaq të rëndësishme siç është buxheti për vitin e ardhshëm, opozita nuk merr pjesë. Ajo duhet të vinte këtu për të dhënë opsionet dhe vërejtjet e saj për buxhetin, pavarësisht votimit, për të cilin asnjë opozitë nuk voton pro. Megjithatë, ne jemi të detyruar të vazhdojmë punën.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Padyshim, momenti kur diskutohet projektbuxheti i shtetit për vitin pasardhës është një moment shumë i rëndësishëm. Ai tregon përgjegjshmërinë që kemi ne, si të zgjedhur, ndaj këtij momenti që lidhet me zhvillimin ekonomik të vendit. Edhe nëse shohim zhvillimin ekonomik për vitin 2019, në këtë projektbuxhet është bërë shumë kujdes që rritja ekonomike të jetë e qëndrueshme dhe parashikimi është që rritja e PBB-së të jetë 4%.

Gjithashtu, niveli i papunësisë në projektbuxhetin që na është paraqitur, synohet të rrijë në vlerën 12%.

Përveç kësaj, në këtë projektbuxhet merren në konsideratë edhe lehtësira të tjera fiskale, të cilat kanë të bëjnë me disa sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si dhe elemente, të cilat sjellin rritjen e mirëqenies së familjeve shqiptare. Kjo ka të bëjë me rritjen e pagave për punonjësit që vijnë, sidomos, nga sektori i arsimit parauniversitar dhe atij të mesëm profesional.

Në të gjithë paketën që kemi marrë në shqyrtim, një nga gjërat që na bën përshtypje, dhe këtë kemi nevojë ta diskutojmë edhe me ju, zonja Ministre, është se si ky buxhet arrin të shkojë edhe në linjën e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të mijëvjeçarit, për të cilët ne, si deputetë, kemi miratuar edhe një rezolutë. Një pjesë e rëndësishme e këtyre objektivave lidhen edhe me arsimin gjithëpërfshirës.

Kështu, po jua kaloj fjalën, duke ju dhënë mundësi të na tregoni impaktin që ka ky buxhet në popullatën shqiptare për sa i takon fushës së arsimit.

Lindita Nikolla – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Të nderuar kolegë,

Është e vërtetë që buxheti dedikuar shërbimit të arsimit për vitin 2019 shëndosh objektivat dhe të gjithë treguesit me të cilat matet puna e të gjithë sektorit të arsimit në vend, dhe këtu kam parasysh arsimin nga kopshti deri në universitet dhe, sigurisht, edhe programet e tjera që lidhen me objektivat madhore për sportin dhe për zhvillimin e rinisë.

Fare shkurt desha t'i kaloj, megjithëse ju e keni përpara materialin e depozituar nga MASR-ja, vlerësimin dhe relacionin përkatës dhe në përgjigje të vëmendjes suaj se sa dhe si reforma e ndërmarrë në sistemin arsimor, po i përgjigjet zhvillimit të qëndrueshëm, të kishim pikë reference se si kontribuon buxheti i vitit 2019 në realizimin e objektivave.

Në krye të herës dua të them se reforma që kemi ndërmarrë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe atij të lartë, është mbështetur mbi parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe, sigurisht, në strategjitë, objektivat dhe parimet mbi të cilat ndërtohen standardet europiane të arsimit 2013.

Për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për vitin 2019 janë planifikuar fonde me një vlerë totale prej 38 miliardë e 167 milionë lekësh.

Buxheti i MASR-së për vitin 2019 krahasuar me planin e buxhetit të rishikuar të vitit 2018, ka pësuar rritje me 792 milion lekë ose 2,07% më shumë sesa viti që po lëmë pas. Rritja reflektohet kryesisht në:

- shpenzimet korrente, të cilat janë shtuar në total me 613 milionë lekë dhe përfaqësojnë kryesisht vijimin e realizimit të premtimit për përfshirjen në skemën e subvencionit të teksteve falas për nxënësit e klasës I-V;

- shpenzimet kapitale/investimet janë shtuar në total me 180 milionë lekë më shumë sesa buxheti i rishikuar i vitit 2018, ose 5% më shumë, krahasuar me një vit më parë.

Më lejoni të bëj një shënim: rritja e pagave në vitin 2019 për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar me 7%, nuk është parashikuar në buxhetin e MASR-së, pasi është mbajtur në fondin rezervë dhe alokohet prej Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2019 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në raport me totalin e shpenzimeve buxhetore arrijnë shifrën 7,48% dhe në raport me produktin e brendshëm bruto arrijnë në 2,23%.

Më lejoni t'ju sjell në vëmendje që ky është vetëm buxheti për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Këtu nuk janë përfshirë fondet që janë caktuar për sektorin e arsimit, që lidhen me arsimin profesional; fondet që dedikohen për arsimin parashkollor dhe transferta e kushtëzuara për njësitë e qeverisjes vendore për arsimin; fondet nga projektet e veçanta të donatorëve; të ardhurat që i dedikohen arsimit të Ministrisë së Mbrojtjes apo të Ministrisë së Brendshme, që i kanë IAL-të dhe, padyshim, këtu nuk jepen të ardhurat dytësore të IAL-ve.

Nëse do të konsideronim edhe këto buxhete, atëherë fondet për sektorin e arsimit të parashikuara për vitin 2019, si pjesë e buxhetit për shërbimin arsimor, parashikohet të arrijnë në total vlerën 57,8 miliardë lekë, që do të thotë 11,04% krahasuar me totalin e shpenzimeve publike dhe 3,3% të PBB-së.

Referuar programeve buxhetore, lejomëni t'ju them se për shërbimin e arsimit parauniversitar fondet totale janë 29,7 miliardë lekë, për të mundësuar përmbushjen e performancës që lidhet me raportin e nxënësve për klasë, sepse synojmë reduktimin edhe më tej të këtij raporti. Në zonat urbane do të ketë 28-30 të tillë përmes investimeve në infrastrukturën shkollare. Për bashkinë e Tiranës, ku evidentohet numri më i madh apo raporti më i lartë i nxënësve në klasë, ka filluar projekti për ndërtimin e 17 shkollave të reja me partneritetin publik-

privat, ku MASR-ja do të kontribuojë me një buxhet vjetor prej 700 milionë lekësh për një periudhë 7-vjeçare, duke filluar nga viti 2020. Aktualisht është nënshkruar një kontratë për ndërtimin e 5 shkollave, loti i parë, me një vlerë totale prej 2,5 miliardë lekësh dhe janë në proces prokurimi 3 lote të tjera, që kryhen nën monitorimin dhe nën përgjegjësinë e Bashkisë së Tiranës.

Një moment tjetër, që lidhet me arsimin gjithëpërfshirës dhe barazinë në sistemin arsimor, një tregues i rëndësishëm që e mat këtë është ai i braktisjes shkollore. Ne parashikojmë edhe pse praktikisht kemi përqindjen më të ulët të braktisjes shkollore në masën 0,57%, synojmë që kjo përqindje të çohet drejt zeros.

Gjithashtu, brenda 2 vjetëve parashikohet që 98% e nxënësve që do të mbarojnë arsimin bazë, të regjistrohen në një nga format/ llojet e arsimit të mesëm: arsim profesional apo gjimnaz.

Targeti ynë për 2 vjetët e ardhshëm është që 65% e tyre të ndjekin gjimnazin dhe 35% e tyre të ndjekin arsim profesional.

Do të doja të ndalesha në disa shërbime të realizuara tashmë, për të cilat jo vetëm ky buxhet do të përmbushë dyfishimin e pages, që është 700 mijë lekë, për mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Patjetër, krijojmë edhe lehtësira të tjera që lidhen me shërbimin psiko-social, duke mundur një psikolog dhe një punonjës social për 3500 nxënës.

Po ashtu, për problemin e sigurisë në shkolla ky buxhet mundëson funksionimin e 150 punonjësve të sigurisë për shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm. Ne po bashkëpunojmë edhe me donatorët, edhe me Ministrinë e Brendshme në mënyrë që alokimi i oficerëve të sigurisë, jo vetëm të rrisë kushtet e sigurisë në shkolla, por të mundësohet që të jenë një element i rëndësishëm bashkëpunimi edhe me komunitetin, edhe me pushtetin vendor, edhe me komisaritet e policisë në mënyrë që shkolla jo vetëm brenda mureve të saj, por edhe në rrethin e dytë dhe në rrethin e tretë, të ofrojë siguri për të mbajtur larg të gjitha veseve apo momenteve që ne duhet t'i adresojmë, të cilat lidhen me krimin, me drogën, apo me shfaqjet e dhunës.

Për zhvillimin profesional të mësuesve kemi një skemë në të cilën do të përfshihen trajnimet e mësuesve që vijnë nga minoriteti, si edhe trajnimin e rreth 70 mësuesve të diasporës për mësimin plotësues të gjuhës shqipe edhe me atë që është tashmë standard, për trajnimin e mësuesve që janë në sistem përmes një skeme ku Instituti ynë i Zhvillimit të Arsimit ka të detajuar

një plan veprimi, bazuar mbi nevojat specifike që kanë dalë përmes procesit të monitorimit, të implementimit të kurrikulës së re në sistemin e arsimit parauniversitar.

Është në proces një moment i rëndësishëm adresimi edhe nga ky buxhet, reformimi i arsimit parashkollor. Ne kemi thënë se investimi në moshë të hershme është një investim i qëndrueshëm, i cili bën pjesë edhe në atë që është një nga objektivat madhore të sistemit arsimor për të mundësuar zhvillimin e qëndrueshëm. Një dollar i investuar në moshë të hershme, i kthehet shoqërisë pas në mënyrë të drejtpërdrejtë me 7 dollarë dhe në mënyrë të tërthortë edhe 2-fish. Ndaj, ne kemi jo vetëm kurrikulat, por standardet e edukatorëve të pasuar me një proces mirëfilli trajnimi të rreth 1000 edukatorëve me programet e reja të miratuara në vitin 2018 për çdo grupmoshë që i adresohet zhvillimit profesional në sistemin arsimor, do të mundësohet pikërisht nga buxheti..

Po ashtu, ky buxhet mundëson në vlerën e 650 milionë lekëve tekstet shkollore falas që do të aplikohen në vitin e ardhshëm, edhe për klasën e pestë. Sigurisht, edhe për të gjitha kategoritë e tjera nga klasa e gjashtë deri në klasën e dymbëdhjetë në vlerën 18 milionë lekë deri në 20 milionë lekë do të shkojnë për kuotën ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta, për rreth 1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë; 40 milionë lekë do të shkojnë për veprimtarinë e Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe Inspektoratit; 50 milionë lekë në vit do të shkojnë për shpenzimet e veprimtarisë së maturës shtetërore, provimet e shtetit, si dhe testimet kombëtare e ndërkombëtare, çka do të thotë se është një fond që Qendra e Shërbimeve Arsimore të mund ta standardizojë këtë proces dhe, sigurisht, të kemi një sinjal të ri, që lidhet me një cilësi të re të shërbimeve, por edhe cilësi të re të matjes së gjithçkaje që ne kemi ndërmarrë në sistemin tonë arsimor.

Do të doja të fokusohesha pak më shumë tek investimet kapitale që mundëson buxheti i vitit 2019. Janë gjithsej 65 projekte investimesh në proces, financimi i të cilave vijon edhe në vitin 2016; 44 projekte janë për ndërtime dhe rikonstruksione në arsimin bazë, me vlerë detyrimesh për t'u financuar në vijim prej 1 miliard e 397 milionë lekësh; 18 projekte në arsimin e mesëm të përgjithshëm, me vlerë detyrimesh për t'u financuar në vijim prej 732 milionë lekësh. Kemi investime të reja në arsimin parauniversitar të planifikuar në një fond prej 819 milionë lekësh, të cilat shkojnë për blerje pajisjesh, për mobilimin me banka shkolle, tavolina dhe gjithçka tjetër që është e nevojshme për 30 objekte të reja shkollore. Fondi prej 60 milionë lekësh do të shkojnë për

laboratorë didaktikë, ku 70 do të jenë laboratorë të fizikës, kimisë e biologjisë, nga të cilët do të përfitojnë 25 shkolla ose 3500 nxënës dhe 200 mësues; blerje didaktike në vlerën e 25 milionë lekëve për arsimin parashkollor, domethënë për kopshtet, dhe një financim prej 631 milionë lekësh për projekte infrastrukture në arsimin parauniversitar, ku parashikohet të financohen 25 objekte arsimore, ndërtim e rikonstrukcion shkollash me vlerë totale 1 miliard lekë, nga ku do të përfitojnë rreth 250 klasa të reja mësimore, 5500 nxënës apo 350 mësues. Gjithashtu, do të ketë blerje në vlerën e 20 milionë lekëve për librin artistik për shkollat e arsimit parauniversitar, për pasurimin e bibliotekave, një proces që ne po e kryejmë në mënyrë të studiuar së bashku me autorë, studiues, si dhe me akademikë që vijnë nga Fakulteti i Filologjisë dhe Historisë.

Për sa i takon arsimit të lartë për vitin 2019, buxheti i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, pa përfshirë fondet jashtëbuxhetore, është planifikuar në një vlerë totale prej 8 miliardë e 74 milionë lekësh, çka nënkupton 20,62% të fondeve totale të Ministrisë së Arsimit, 0,47% të prodhimit të brendshëm bruto ose 1,54% ndaj shpenzimeve publike.

Këto janë vetëm fondet e buxhetit. Nëse shtojmë edhe fondet e...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse shikojmë edhe fondet nga të ardhurat e institucioneve të arsimit të lartë, të planifikuara për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, këto zënë 32% të fondeve totale të Ministrisë së Arsimit, 0,72% ndaj prodhimit të brendshëm bruto ose 2,4% ndaj shpenzimeve publike.

Buxheti i arsimit të lartë për vitin 2019 ka shënuar një rritje prej 3,7% ose 290 milionë lekë më shumë sesa buxheti i vitit 2018, rritje e cila është orientuar kryesisht në shpenzimet kapitale, që janë afro 5% më shumë sesa në vitin 2018.

Gjithashtu, edhe buxheti për kërkimin shkencor në vitin 2019 ka një rritje me 29% ose 101 milionë lekë më shumë krahasuar me vitin 2018, e cila destinohet kryesisht për projektet kërkimore-shkencore, që vijnë nga institucionet e arsimit të lartë.

Fondet nga buxheti i shtetit shpërndahen në formë granti për politikat e zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe grant i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, sipas kritereve:

a) granti i politikave të zhvillimit, që presupozon jo më pak se 10% të totalit të grantit vjetor;

b) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese parashikohet jo më pak se 5% e totalit të grantit vjetor.

Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë përfshin si fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike, ashtu edhe fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Ky fond detajohet nga bordet e administrimit të vetë institucioneve të arsimit të lartë edhe në kuadrin e rritjes së autonomisë financiare të institucioneve të arsimit të lartë, ndërsa fondi prej 640 milionë lekësh i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë shpërndahet mbi bazën e projekteve, sipas kriterëve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.

Aktivitetet kryesore që mbulohen nga buxheti 2019 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ndahen në fonde si më poshtë: fonde për mbështetjen e studentëve për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, si dhe studentëve ekselentë në institucionet e arsimit të lartë publik në shumën e parashikuar prej 400 milionë lekësh në vit. Ky fond u jep mundësinë studentëve për të ndjekur studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, kategori të caktuara të studentëve, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të përballuar kostot e shkollimit.

Lejomëni të shtoj këtu edhe fondin që alokohet në kuadër të reformës së mësuesisë. Për të gjithë studentët ekselentë, që kanë një notë mesatare mbi 9 dhe kanë zgjedhur mësuesinë, qeveria shqiptare, për herë të parë, mbulon jo vetëm tarifat, por alokon për ta edhe një bursë që kap vlerën e 1000 dollarëve.

Fonde të tjera janë: për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike (6,8 miliardë lekë), detajohet nga bordet e administrimit të vetë institucioneve të arsimit të lartë; fonde për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin e tyre në tetë shoqëritë e trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në rrethe, ku parashikohet të akomodohen rreth 14 mijë studentë, janë

parashikuar 350 milion lekë në vit; fonde për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve ekselencë, që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “*Times Higher Education*”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe të tretë në 300 universitet më të mira të botës. Pra, si çdo vit fondi i ekselencës është parashikuar në vlerën e 180 milionë lekëve.

Gjithashtu, do të ketë mbështetje financiare për studentët praktikantë dhe personelin akademik për të studiuar jashtë vendit, mbështetje për sportin dhe aktivitetet rinore, duke e bërë Shqipërinë tashmë pjesëmarrëse me titull të plotë në programin “Erasmus+”, pjesëmarrëse në programin “Horizon 2020”, që është programi i BE-së për kërkim dhe inovacion, si dhe në programin “Eurostudent”, që në total kap shifrën e 140 milionë lekëve në vit.

Besoj se jo vetëm buxheti, por edhe gjithçka që kemi nisur tashmë me reformën tonë në arsimin e lartë (me akreditimin institucional dhe fillimin e procesit të akreditimit të programeve të studimit, me kurrikulat e reja të performuara në fakultetet që kanë programe të mësuesisë), po ashtu nëpërmjet vendosjes së aksesit për universitetet në bibliotekën online, si dhe fillimin e një investimi për të rinj e të reja studentë dhe jo vetëm, por edhe nga komuniteti për gjuhën angleze, duke mundësuar kurse falas, besoj se është janë mundësi të reja zhvillimi për institucionet tona të arsimit të lartë.

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit pa dyshim ka në vëmendjen e saj edhe fuqizimin e programeve që lidhen me sportin dhe rininë, ku edhe në buxhetin e vitit 2019 janë parashikuar 500 milionë lekë, nga të cilat 26,7 milionë lekë shpenzime për personelin, 223,2 milionë lekë shpenzime korrente dhe 250 milionë lekë shpenzime kapitale.

Sigurisht, besoj se këto do të shërbejnë për të vijuar edhe më tej gjithçka që ne kemi nisur në këta dy komponentë, madje jo thjesht dhe vetëm sporti meriton më shumë vëmendje (sporti elitari) dhe gjithçka që lidhet me federatat dhe llojet e ndryshme të sportit, por çka vlen të ritheksohet është fakti se sporti dhe jeta e shëndetshme po kthehen në një komponent të rëndësishëm në të gjithë sistemin tonë arsimor. Tashmë është realitet funksionimi i dy federatave të sportit shkollor dhe Federatës Universitare, që kanë bërë të mundur rivitalizimin, jo vetëm rikthimin e klasave sportive, por edhe të një jete shumë më të pasur sportive në të gjitha komunitetet rinore në çdo shkollë, po ashtu edhe në universitet.

Me buxhetin e vitit 2019 do të sigurohet mbështetja financiare për personelin dhe aktivitetet sportive të agjencisë së sportit, agjencive rinore, si dhe fonde grant për rreth 20 federata sportive, kjo në shumën e 141,3 milionë lekëve; mbështetje financiare për shpërblimin e sportistëve me rezultate kombëtare dhe ndërkombëtare në shumën e 40 milionë lekëve; financimin e aktiviteteve rinore me 33,4 milionë lekë; financimin e kontributeve të rinisë dhe federatave sportive në organizma ndërkombëtarë prej 30,2 milionë lekësh; financimin e projekteve në vazhdim nga viti 2018 për infrastrukturën sportive 12 projekte (palestra dhe terrene sportive) me vlerë detyrimi prej 374 milionë lekësh dhe financim për vitin 2019 në masën 224 milionë lekë. Vlera e plotë e këtyre projekteve është 730 milionë lekë, si dhe do të përmbushim financimin e tri qendrave rinore dhe pajisjen e tyre me orë në vlerën 26 milionë lekë.

Patjetër, diskutimi për buxhetin, që lidhet me shërbimin arsimor, nuk shteron, jo vetëm në vende si yni, me buxhete të limituara, por edhe në vende më të zhvilluara. Sa më shumë të investohet në arsim, sa më shumë të investohet në sport, sa më shumë të investohet në zhvillimin e rinisë, patjetër që aq më shumë ne kemi investuar në të ardhmen e vendit apo në atë që ju, me të drejtë, e thatë, në zhvillimin e qëndrueshëm. Por ajo që është mjaft e rëndësishme për t'u thënë është fakti se institucionet që monitorojnë punën e qeverisë shqiptare, në veçanti reformat e ndërmarra në arsim, përtej debatit buxhetor, thonë se në krahasim me vende të tjera të rajonit, por edhe më gjerë, që alokojnë të njëjtat buxhete në arsim, Shqipëria ka një performancë shumë më të mirë. Kjo do të thotë se buxheti po përdoret në mënyrë eficiente për të shëndoshur pikërisht ata objektiva që lidhen me një cilësi të re në sistemin tonë arsimor, e krahasuar me standardet më të mira europiane.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Nikolla!

Kolegë, doni të vazhdojmë me Ministrinë e Financave, apo do t'i bëjmë pyetje Ministrisë së Arsimit?

Atëherë, do të vazhdojmë me prezantimet.

Zoti Opre, a mund të na thoni se çfarë është parashikuar për arsimin profesional, pra për buxhetin dhe targetimin që keni në buxhet lidhur me arsimin profesional?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, zoti Opre, se ka një keqkuptim nga ana ime. Kolegët deputetë duan t'i bëjnë pyetje zonjës Nikolla, pastaj të vazhdojnë me ju.

Kush e do fjalën?

Po, zoti Nasufi, pastaj do ta marrë fjalën zoti Beqiraj.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja Ministre, për parashtrimin që bëtë për buxhetin e vitit 2019 për Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve!

Meqenëse ky është debati i parë që po zhvillojmë për projektbuxhetin e vitit 2019, dua të them disa konsiderata të përgjithshme për këtë projektbuxhet. Ky është një projektbuxhet i shëndetshëm, i cili, siç e thatë edhe ju, e nderuar zonja Milva, fillon me një rritje ekonomike prej rreth 4%. Është një buxhet i strukturuar dhe analitik qoftë edhe si formatim, ku të gjitha njësitë shpenzuese kanë kaluar në filtër, ku çdo financë adresohet me shumë studim dhe përgjegjshmëri. Është një buxhet që shkon drejt objektivave dhe prioriteteve që ka caktuar. Kjo do të thotë se ka parashikueshmëri të hershme që nga fillimi i mandatit dhe ne tani i mbështesim me financat përkatëse projektet dhe të gjithë objektivat që kemi shpallur në prioritetet tona të qeverisjes. Ky buxhet mban nën kontroll borxhin publik, por edhe shkon në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe në mënyrë të tërthortë me përfitimet publike, qoftë në fushën e investimeve, qoftë edhe në fushën e rritjes së pagave dhe në çdo drejtim tjetër, ku kanë pritshmëri njerëzit. Në fund të fundit, japim mesazhin që ne ndërtojmë një buxhet, të cilin nuk e mbështesim thjesht te dëshirat, por te projektet, te prioritetet dhe te mundësia e financave, të cilat kemi arritur me shumë sakrificë t'i shëndoshim në këta 5 vjet që qeverisim si maxhorancë socialiste. Kjo do të thotë se ne hapim kantiere pune dhe investimesh, rrisim pagat, aq sa kemi mundësi financiare dhe nuk fillojmë një punë sot, e cila mbetet cikël i hapur dhe i pambyllur qoftë në fushën e investimeve, qoftë edhe në pritshmëritë e tjera që ka publiku.

Ministrja parashtroi të gjithë panoramën e përfitimeve që ka në të gjitha ciklet e arsimit buxheti, ku parashikohet dhe planifikohet një total shpenzimesh kapitale dhe korrente prej 39 miliardë lekësh. Ky buxhet shkon drejt rritjes. Po ashtu, ne kemi prioritet për të rritur GDP-në në arsim dhe për të shkuar te mesatarja që kanë vendet e Bashkimit Europian. Nuk është akorduar thjesht kjo shifër prej 39 miliardë lekësh, por janë rreth 7,4 miliardë lekë, të cilat i shkojnë pushtetit vendor në pjesën sektoriale, që duke filluar nga viti 2019 do të jetë pjesë e transfertës së

pakushtëzuar. Në vitet 2016-2018 ka qenë për të mbështetur pikërisht funksionet e deleguara të pushtetit vendor në reformat që janë kryer, edhe për reformën e decentralizimit, si dhe për problemet e tjera që ka pushteti vendor nga fuqizimi.

Unë do të sjell në vëmendje të komisionit, por edhe të publikut faktin që në këtë paketë reforma e arsimit parashkollor mbështetet me 327 milionë lekë, ku fondi për personelin mësimor të kopshteve në arsimin parauniversitar është 3,6 milionë lekë. Siç është bërë me dije, në mbështetjen financiare, por edhe në programin që ka shpallur qeveria do të synohet të ulët numri i nxënësve të arsimit parashkollor nga moshë 3 vjeç deri në 6 vjeç, nga 18 nxënës në 15 nxënës në grup dhe në bashkitë e mëdha urbane që mund të kenë 26-28 nxënës do të ulët përsëri ky numër, duke shtuar edhe financimin për shtesë të edukatorëve. Është parashikuar që investimi të fillojë pikërisht nga moshat më të vogla, siç janë fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Kështu që ky ndryshim jo vetëm reflektohet mbi bazën e ndryshimeve sociale dhe demografike që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe, por synon edhe rritjen e cilësisë dhe rritjen e detyrimit që prindërit të nxiten për të frekuentuar arsimin parashkollor në të gjithë territorin e Shqipërisë. Të gjitha këto shifra çojnë jo vetëm në rritjen e personelit në funksion të fëmijëve të arsimit parashkollor, por çon edhe në një rritje gati 9,1% të pagave që do të ketë kjo kategori. Kështu që i mbetet detyrë edhe pushtetit vendor, edhe për fondet që akordohen në arsimin parauniversitar, t'i menaxhojë me përgjegjshmëri të gjitha buxhetet që akordohen dhe të ruajë cilësinë e reformës në arsim në të gjitha ciklet e shkollimit. Ky pushtet vendor mbështetet financiarisht, por edhe me kompetenca nga maxhoranca socialiste.

Për sa u përket treguesve të tjerë të buxhetit për Ministrinë e Arsimit, ministrja i bërë prezentë. Veç buxhetit të akorduar, aty ka edhe një financim të huaj prej 200 milionë lekësh, të cilat parashikohen jo thjesht për buxhetin e vitit 2019, por deri në vitin 2021.

Një nga pyetjet që dua të shtroj është: si punon Ministria e Arsimit për të siguruar burime të huaja financimi për arsimin? Ne kemi pasur raste që kemi kaluar edhe marrëveshje në diskutimet që kemi zhvilluar.

Në projektbuxhet thuhet se për periudhën 2019-2021 do të rikonstruktohen, në përputhje me standardet bashkëkohore rreth 170 objekte arsimore apo 1500-1700 klasa. Jemi të interesuar të kemi një listë të studimit të parashikuar sipas qarqeve kryesore të shkollave që kërkojnë investime apo rikonstruksione.

Risi është fakti që ulet shërbimi i transportit të nxënësve nga 5 kilometra në 2 kilometra. Po kështu, do të mbështetet edhe transporti i mësuesve me largësi nga shkolla deri në 5 kilometra. Ndërkohë, tani është sanksionuar dhe është mbështetur edhe në buxhet ndarja e librave falas për rreth 190 mijë nxënës, si dhe bursa për studentët jo vetëm për ata që vijnë nga shtresat në nevojë, por edhe për studentët ekselentë.

Në të gjithë panoramën që ka buxheti, që sqaroi edhe zonja Nikolla, unë e shikoj në rritje jo vetëm trendin financiar, por edhe programin me të cilin ne do të mbështesim arsimin në Shqipëri. Besoj se mbështetja financiare do të materializojë edhe objektivat që ne kemi shpallur për të rritur cilësinë e arsimit dhe për të përmbushur reformat, të cilat kanë filluar të japin rezultate sipas pritshmërive publike, ndonëse me shumë vështirësi, të cilat janë krijuar nga tranzicioni.

Kështu që neve na mbetet detyrë që buxhetin ta votojmë në parlament dhe t'i japim shpejtësi në realizim.

Në rast se do të flisnim për disa prioritete që janë në akord edhe me lëvizjet demografike, pra në ato qendra ku ka popullsi të qëndrueshme dhe frekuentim të vazhdueshëm dhe konstant të nxënësve, do të thosha që në Berat prioritet mbetet investimi në gjimnazin “Babë Dudë Karbunara” dhe në shkollën nëntëvjeçare në Mangalem, në shkollën e Otlakut, të Paftalit, të Drobonikut, të Roshnikut, të Vojnikut dhe në Urën Vajgurore në shkollën e mesme të Drenovicës, Donofrosës dhe në Kuçovë në shkollën nëntëvjeçare në Sheqëz. Këto janë prioritete të studiuara lidhur me gjendjen e amortizuar që kanë shkollat. Nuk janë investime që mbeten kot, se klasat nuk do të na mbeten bosh për mungesë të frekuentimit të nxënësve.

Unë uroj që ky buxhet të realizohet dhe të pasurohet me donacione të tjera nga i gjithë rrjeti i donatorëve që kemi dhe të partnerëve të tjerë që kontribuojnë në Shqipëri.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Të nderuar kolegë, dua t'ju vë në vija në dijeni edhe për diçka: ne e kemi ndarë në tri momente diskutimin për buxhetin, pra në parim, nën për nën dhe pastaj në tërësi. Kështu që në këtë moment jemi duke zhvilluar diskutimin në parim për të parë se si buxheti, që ka planifikuar Ministria e Arsimit, është negociuar me Ministrinë e Financave dhe nëse i plotëson apo jo pritshmëritë që kemi ne sipas programit për këtë buxhet. Kështu që, ju lutem shumë bëni pyetje që sqarojnë buxhetin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Fadili foli gjatë për këtë projektbuxhet. Sigurisht që, edhe pse drejtuesja e mbledhjes së komisionit na sugjeroi, ne nuk shpëtojmë dot edhe nga ndonjë koment i shkurtër.

Unë do ta filloj më një shprehje të popullit lidhur me projektbuxhetin e vitit 2019 dhe buxhetin afatmesëm 2019-2021, që thotë: “Oreksi vjen duke ngrënë”. Në cilin koncept e them këtë shprehje popullore?! Në shprehjen që ne sot po diskutojmë një projektbuxhet....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë projektbuxhet po e diskutojmë jo si projekt emergjence, jo si projekt në kushtet që arsimi ka probleme të jashtëzakonshme, por po e diskutojmë si një projekt për të arritur standardet më të larta.

Para se të bëj disa pyetje që kërkojnë më shumë sqarim, dua të them se nuk kam si të mos e përsëris që në sistemin e arsimit në tërësi, sidomos në atë parauniversitar, janë bërë dhe janë implementuar një sërë nismash, një sërë risish të reja dhe një sërë praktikash, që nuk i kishim ndeshur asnjëherë. Këto nisma dhe akte nënligjore, që kanë marrë fuqi të plotë, kërkojnë jo vetëm të implementohen, por nga pas ato kanë faturën financiare. Nuk dua të zgjatem, sepse do të diskutojmë edhe në seanca të tjera, por dua të bëj disa pyetje.

Duke parë materialin që keni prezantuar, por edhe materialin që ministri i Ekonomisë dhe Financave ka nxjerrë dhe është miratuar si projektligj nga qeveria, relatoni që në fillim se fondet buxhetore të planifikuara për këtë vit janë 38 miliardë e 167 milionë lekë. Pyetja ime është: sa për qind e GDP-së zë ky fond dhe, krahasuar me atë të vitit 2018, sa për qind është rritur? Me këtë ritëm rritjeje, a i realizojmë dot objektivat strategjike për arsimin në Shqipëri, që kjo maxhorancë i ka vënë vetes me marrjen e këtij mandati?

Që në fillim të këtij viti shkollor në shumë zona ka pasur probleme me transportin e nxënësve dhe arsimtarëve. A është parashikuar në fondet e dedikuara për këto shërbime, duke përfshirë edhe tarifën e transportit, në mënyrë që të mos ndeshemi me fenomene të tilla, të cilat i ndeshëm nga bashkimi i disa shkollave që u mbyllën për shkak të uljes së numrit të nxënësve?

Ky buxhet mbështet plotësisht të gjitha rrisitë, nismat e ndërmarra nga ju, si dhe aktet nënligjore që po implementohen. Edhe pse u mbyllën shkollat, asnjë nga mësuesit nuk doli nga sistemi i procesit të mësimdhënies, por u akomoduan në shkollat e tjera; është rritur numri i specialistëve në fushën e shërbimit psikolog dhe social; është rritur numri i oficerëve të policisë

nëpër shkolla dhe plot aktivitete dhe nisma të tjera që ministria ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë në të ardhmen. A janë parashikuar në këtë buxhet këto nisma?

Dua të bëj disa pyetje për parashikimet në projektbuxhetin e vitit 2019 për institucionet e arsimit të lartë. Sa për qind zënë financimet në fushën e kërkimit shkencor dhe investimeve kapitale në raport me financimet e institucionit të lartë dhe a ka rritje sipas trendit të kërkesës në këta sektorë?

Meqenëse përmenda investimet kapitale, a është parashikuar në buxhetin e vitit 2019 ndërtimi i një kampusi universitar në Tiranë?

Këtë vit u diskutua rritja e pagave për arsimin parauniversitar deri në 70%, po për institucionet e arsimit të lartë a ka ndonjë parashikim në buxhetin afatmesëm 2019-2021?

Një risi në buxhetin e vitit 2018, të këtij viti dhe atij afatmesëm është ndërtimi i shkollave, sidomos i atyre që do të ndërtohen në vitin 2019. A janë të mjaftueshme fondet për arredimin e këtyre shkollave, apo ndërtohen si ndërtesa të bukura dhe brenda mbushen me banka të vjetra? Një shqetësim tjetër është edhe pajisja me laboratorë në arsimin e lartë, sepse ka universitete që ende procedojnë me laboratorë të para viteve '90.

Dy seanca më parë ne miratua ligjin për ndalimin e kazinove dhe lojërave elektronike dhe një pjesë e nxënësve nga mosha 14-15 vjeç nga 1 janari do të shpëputen nga kthetrat e këtij aktiviteti kriminal në Shqipëri. Për financat dhe kuletën e shqiptarëve për të sotmen dhe të ardhmen e fëmijëve është menduar që kjo kohë të mbushet me aktivitete kulturore artistike, por përsëri ka një faturë shpenzimesh.

Ju faleminderit!

Milva Ekonomi – A ka pyetje për ministren?

Bujar Çela – Unë besoj shumë në shpjegimin që dha ministrja. Ky do të jetë një buxhet që do të bëjë kthesën e rëndësishme në arsim, por a do ta realizojë ky buxhet programin tonë për ecurinë në arsim, ashtu siç kemi premtuar në fushatën e vitit 2017?

Dua të them dy gjëra lidhur me atë që tha zoti Fadil. Berati nuk ka pasur ndonjëherë ministër Arsimi dhe zëvendësministri i radhës mund të jetë nga Fieri; nga Berati nuk e besoj se mund të jetë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi –Në qoftë se nuk ka më pyetje nga kolegët, dua të bëj edhe unë disa.

Në fakt, dua të di nëse këtë vit jemi pjesë e PIZA-s?

A kemi një statistikë se sa vite shkollë kanë bërë fëmijët e grupmoshës deri në 18 vjeç?

A është i rëndësishëm interneti nëpër shkolla dhe sa i aksesueshëm është ai, sepse njohja me të reja inovative është e rëndësishme për çdo fëmijë, pasi synojmë të shkojmë drejt ekonomisë së dijes?

Unë vura re që në buxhet keni planifikuar laboratorë didaktike nëpër shkolla. A jeni udhëhequr nga parimi i ekoproduktivitetit, energjisë së re dhe iniciativave të tjera në këto laboratorë që ju ofroni në arsimin parauniversitar në Shqipëri?

Pyetja tjetër lidhet me një dëgjese që ne kemi bërë më parë në komision për elementët e dhunës në shkolla dhe për raportin vjetor, që ju publikoni për dhunën e fëmijëve në shkolla. A mund ta bëni *online* këtë raport dhe ta bëni të përvitshëm, ashtu siç e keni deri tani eksperiencën e mirë?

Edhe në dëgjesat që kemi pasur më parë me zonjën ministre lidhur me iniciativat e tjera, që kanë të bëjnë me tekstet, me punën e ndershme, me shkollën e drejtorëve, me cilësinë dhe me gjithçka që keni sjellë në komision, kam besimin se këto iniciativa janë parashikuar në buxhet, sepse po të vini re zërat buxhetorë, planifikimi është bërë që deri në vitin 2021 të arrihen të gjitha objektivat që ju keni shënuar, por dua t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve, pasi lidhen edhe me dëshirën që kemi ne për të bërë fëmijë më të ditur në Shqipëri.

Lindita Nikolla –Faleminderit shumë për të gjitha komentet dhe pyetjet, që tregojnë edhe një herë një vlerë të shtuar të përgjegjshmërisë, në mënyrë që jo vetëm të raportojmë se sa buxhet investohet në sistemin arsimor, por edhe sa dhe si ky buxhet po përkthehet në standarde të reja në sistemin tonë arsimor. Kjo është shumë e rëndësishme. Patjetër ju, të nderuar kolegë dhe opinioni publik, do të njiheni me raportimet e institucioneve të rëndësishme, siç është Banka Botërore, por edhe të institucioneve të OECD-së. Ne do të marrim rezultatet e PIZA 2018, që do të jetë një instrument shumë i rëndësishëm për të parë progresin në raport me cilësinë.

Dua t'ju them se përfaqësuesit e lartë të Bashkimit European në takimin e fundit në Beograd thanë se Shqipëria ka bërë një progres shumë të madh në rezultatet PIZA 2015, që ishin vetëm 2 vjetët e parë të implementimit të reformës sonë kurrikulare. Dua ta përsëris: ne nuk kemi rregulluar vetëm disa tekste këtu apo kemi ulur ngarkesën diku tjetër nga pikëpamja e peshës, në përmbajtje, por kemi një fokus krejt të ri të shkollës shqiptare, kemi një qasje krejt të re, me të

cilën operon arsimi ynë, që është i krahasueshëm me standardet më të mira të vendeve të OECD-së.

Nëse u referohemi rezultateve të PIZA-s, ajo gjithmonë mat kompetencën të 15-vjeçarët, gjë që shkolla jonë nuk e kishte në vizionin e saj, sepse kurrikula e vjetër jo vetëm ishte teje e mbingarkuar, jo vetëm nuk kishte koherencë nga një cikël në tjetrin, por bazohej tek objektivat. Pra, sa dhe si në një orë të caktuar, në një temë të caktuar, i riu dhe reja, nxënësi shqiptar arrinte të performonte, të fliste për njohurit apo të ndante dhe të përsëriste informacionin që kishte marrë.

Tashmë kemi një sistem krejt të ri, jo vetëm që nuk kemi një vlerësim me një notë mesatare, por kemi një progres në tri semestra se si formohet kompetenca. Nga ana tjetër, ajo që është shumë e rëndësishme, nuk jemi të interesuar për të parë sa dhe si i kanë njohurit në mendjen e tyre nxënësit, si i përsërisin ato, por shkolla po i përgatit ata me aftësinë për t'i përdorur këto informacione dhe këto njohuri për të zgjidhur problemet e jetës. Kjo është qasja e re dhe fokusi i ri, në të cilën punojnë të gjitha shkollat.

Për sa i takon pyetjes që ju thatë, sigurisht ka matje, këtu nuk doja të ndaja mendimin, nëse ka institucione të caktuara, ku matim njohuritë e një 15-vjeçari shqiptar në raport me njohuritë dhe dijet e një nxënësi 15-vjeçar apo 18-vjeçar finlandez. Ne duhet të themi si do të jetë progresi ynë, këtë do ta shikojmë këtë pas daljes së rezultatit të PIZA 2018, ku unë besoj fort se, edhe pse kemi një situatë të re, që lidhet me testimin jo në fletë, por është bërë dixhital, përsëri do të kemi një progres të ri të shtuar të sistemit tonë arsimor, për të cilin, pa dyshim dua të falënderoj të gjithë armatën e madhe të mësuesve!

Momenti tjetër që ju thatë ka të bëjë me faktin se edhe ky buxhet adreson 60 milionë lekë të rinj, që lidhen me internetin në shkolla. Por, nëse flasim vetëm për shifrën, dua të them se, përtej shifrës, që patjetër mundëson qasjen në internet dhe aksesin me internet të shkollave shqiptare, kompetenca dixhitale është një nga 7 kompetencat kyçe në të cilat sot operon i gjithë sistemi ynë i arsimit parauniversitar. Jo vetëm me buxhetin e shtetit, por edhe me donatorë të ndryshëm, siç është *british cuncil*, por edhe me institucione të tjera, ne, me fondet e tyre po realizojmë, së pari, trajnimin e mësuesve, sigurisht, dhe disa programe specifike, që lidhen me kodimin në kurrikulën e arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm.

Sigurisht, laboratorët didaktikë nuk prodhohen në zyrën e ministres së Arsimit dhe as në zyrat e Ministrisë së Arsimit, por janë operatorë që u janë referuar standardeve më të mira. Besoj

se këto standarde do të jenë edhe të energjisë së rinovueshme, që ju zonja kryetare pyetët, pra janë standardet më të mira dhe kur konkurrojnë, patjetër zgjidhen konform realizimit më eficient dhe më të plotë të këtyre standardeve.

Për sa i takon dhunës në shkolla, besoj se e gjithë reforma jonë që lidhet me funksionimin e shkollave, si dhe qendra komunitare, strategjia jonë kombëtare për edukimin kundër fenomeneve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, futja e 150 oficerëve të sigurisë, ndërveprimi dhe komunikimi midis institucionit të prindërve, duke i kthyer prindërit në një institucion monitorues në gjithçka që ndodh në shkolla në sistemin tonë arsimor, është një vlerë e shtuar për të mësuar që fenomenet e dhunës të mos kenë vend në shkollat tona, por është gjëja më minimale bërja publike e raportit të matjes së nivelit të dhunës në sistemin tonë arsimor parauniversitar. Por, përtej bërjes publike, ne jemi të vendosur që të operojmë dhe të vijojmë më me shpejtësi për të mos pasur fenomene të tilla në arsimin tonë.

Më lejoni t'ju them se PIZA 2015, dhe ky është dhe një faktor tjetër që vjen nga raporte ndërkombëtare, ka nënvizuar që kur fëmijët shqiptarë u pyetën për rolin e mësuesit dhe si e shikonin figurën e mësuesit dhe këtu jemi të parët, madje duke lënë dhe vende të tjera si Spanja, ku ende fëmijët shqiptarë e shikojnë figurën e mësuesit si një figurë kyçe në procesin e formimit të tyre. Gjë që nga ekspertët e huaj u tha se ky është një faktor shumë i mirë për të qenë shkolla miqësore dhe për të mos pasur fenomene që lidhen me dhunën në shkollë. Megjithatë, ky është një proces, për të cilin jemi të vendosur jo vetëm të kemi situata të reja, por edhe ta raportojmë, po ashtu sikurse të marrim masa direkte kur dhuna vjen nga mësuesit apo nga edukatorët.

Për sa i takon pyetjes tjetër, që lidhet me tarifën e transportit, dua të bëj një korrigjim të vogël, këtu ne nuk po qendërojmë shkolla për shkak të uljes së numrit të nxënësve, arsyeja është të minimizimi funksionimin i klasave kolektive. Pra, fakti që sivjet shkuam në rreth 330 klasa kolektive të mbyllura, duke transportuar fëmijët e këtyre klasave, që nga opozita u pa si mbyllje shkollash, gjithë ai revansh politik rezultoi sot në një situatë të re për fëmijët që vinin nga këto klasa, duke shkuar në klasa normale dhe duke zhvilluar një mësim normal. Do të jetë një proces që do të thellohet në vijim, por që kërkon angazhimin e të gjitha forcave.

Jo kudo pushteti vendor ka bërë detyrën, në kuptimin më të mirë dhe të plotë të kësaj fjalë, sepse jo vetëm mundësojmë një arsim cilësor për këta fëmijë, por, nga ana tjetër, çlirojmë

buxhete të pushtetit vendor, që nuk do të adresohen më në ato shkolla të vogla, ku ka 5 apo 6 fëmijë, por do të jenë të qendëruara dhe të përqendruara për një cilësi të re në sistemin arsimor.

Ne kemi parashikuar rritje të buxhetit për transportin, kemi 650 milionë. Sigurisht, jemi në diskutim me operatorët, por edhe me Ministrinë e Transportit për të rishikuar tarifat që lidhen me transportin. Në këtë moment që jam duke raportuar nuk kemi një përgjigje përfundimtare, sepse vazhdojnë ende negociatat. Ajo është shumë e rëndësishme është fakti se ne nuk do të mbyllim klasa kolektive pa mundur transportin falas të fëmijëve, ashtu sikurse edhe transportin falas fëmijëve të tjerë që lëvizin mbi 2 kilometra nga shtëpia e tyre. Këtu kam parasysh fëmijët, por edhe mësuesit, që lëvizin mbi 5 kilometra.

Patjetër, është një buxhet që mbështet nismat e ndërmarra në arsim. Duke nënvizuar që në fillim, dua ta përsëris se merita, pikërisht është e atyre që i realizojnë këto nisma, që janë mësuesit shqiptarë kudo ku punojnë. Patjetër, tekstet e reja, kurrikula e re, tri lëndë në 6 orë , portali “Mësues për Shqipërinë”, skema e re për trajnimin e mësuesve, reforma në mësuesi, që i dha produktet që këtë vit, reforma në arsimin e lartë, që lidhet me programet 2-vjeçare, dhe këtë vit, si asnjëherë tjetër, kemi një numër shumë të lartë studentësh të regjistruar në programet 2-vjeçare çdo ditë do të japim shifra dhe fakte për produktet dhe frytet që po jep reforma në arsim, sigurisht janë të mbështetura me buxhet dhe hap pas hapi do të flasim për standarde të reja.

Meqenëse jemi sot në këtë takim, dua t’ju them se sot kemi edhe një aktivitet tjetër me maturantët për të folur për gjimnazin e reformuar, që jo vetëm ka përmbyllur një cikël shumë të vështirë të funksionimit të gjimnazeve, në morinë e zgjedhjeve pa zgjedhje, që çau edhe sistemin e menaxhimit të shkollës nga pikëpamja e burimeve njerëzore, por jo vetëm, por kemi edhe maturën e parë, që vjen nga gjimnazi i reformuar, ku është shumë e qartë sapo ka filluar vitin shkollor se cilat janë lëndët që ju mundësojnë vijimin akademik apo suksesin në tregun e punës, që besoj se do të jetë edhe një pjesë e standardeve të reja apo fryteve që po jep reforma e ndërmarrë në sistemin arsimor. Aktiviteti i sotëm do të jetë një aktivitet informues, ku do të flasim vetë maturantët dhe mësuesit, por, patjetër, do të matet edhe me cilësinë e re në maturën shtetërore, sigurisht edhe me cilësinë e re në pranimet në universitet, por unë do t’ju raportoj nesër kur ju do më ftoni për këtë pjesë.

Për sa u takon pyetjeve që lidhen në investimet në shkolla, patjetër ne kemi një hartë investimesh se ku janë edhe prioritetet tona. Sigurisht, rreziku më i madh, nga pikëpamja

infrastrukturore, ku është nevoja, por edhe impakti i përfituesve. Më lejoni t'ju them se ne financojmë projektet që vijnë nga pushteti vendor, pra janë projekte që vijnë nga pushteti vendor dhe ne përmes sekretariatit teknik dhe më pas në vendimmarrjen e komitetit të zhvillimit të rajoneve, realizojmë vendimmarrjen për projektet më prioritare, sigurisht më efeciente nga pikëpamja profesionale dhe teknike që vjen nga pushteti vendor.

Patjetër gjimnazi i Beratit është në fokus, sepse është një gjimnaz i madh nga pikëpamja e përfituesve, por është një gjimnaz cilësor në të gjithë punën e tij edukative dhe mësimdhënëse dhe mësimnxënëse.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Nikolla!

Kemi nevojë të diskutojmë të tjera gjëra apo t'i japim leje, meqenëse ka edhe aktivitetin.

Ta dëgjojmë edhe zotin Ylli, se ka vetëm dy komente të shkurtra?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse ata kanë një aktivitet në ora 13.00.

Fidel Ylli – Do të flas shumë shkurt. Gjithë shqetësimi im është për këtë buxhet shumë të vakët të sportit Shqiptar; ka disa vite kështu. Edhe në mandatin e parë, edhe në këtë mandat të dytë, është po i njëjti buxhet për njëzet e pesë federatat elitare, ndërkohë që ne krenohemi për ata sportistë të mëdhenj që dalin.

Për sa i përket ndarjes, zonja Ministre, ju jeni përgjegjëse në lidhje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ndaj nuk mund t'i lihet në dorë asaj strukture të sportit, që është ministri apo zëvendësministri, që nuk ka asnjë përgjegjësi politike në ndarjen e buxheteve të federatave elitare dhe joelitare. Ne kemi sporte individuale, ku me pak para marrim shumë produkt dhe shumë imazh, por kemi edhe sporte kolektive, ku rrihemi edhe 120 me 10, dhe përsëri marrim buxhete shumë herë më të mëdha se këto sporte individuale. Kjo është një pikë, e cila duhet parë në këtë buxhet.

Tjetër, unë kërkoj një shtesë buxheti, gjë për të cilën do ta ngre zërin edhe te Ministria e Financave, edhe te ju, sepse qeveria ka marrë një vendim, i cili sipas mendimit tim është i drejtë, për mbylljen e kompanive të basteve dhe të lojërave të fatit. Ne nuk duhet të harrojmë se sporti merr 0, 4 % të të ardhurave të këtyre kompanive. Këto kompani mbyllen, ne na reduktohet një buxhet, ndaj mendoj se në këtë buxhet të ardhshëm duhet shtuar një buxhet për sportin elitare.

Ju folët për klasat sportive. Unë mendoj se ne kemi bërë një ligj shumë të mirë, një ligj elitar europian, që e kaluam gjatë mandatit të shkuar, por mendoj se ky ligj që kemi kaluar, është shumë i vonuar në implementimin e tij. Nuk e di nëse ka ngelur për çështje buxheti, për çështje structure, për çështje paaftësie të njerëzve, të strukturave të saj, që drejtojnë sportin në atë ministri.

Është fat që sporti është në Ministrinë e Arsimit, ku ka shumë kuadro të sportit, që ne kemi menduar se mbrojnë Universitetin e Sporteve, por duhet një rakordim me federatat sportive, që këta kuadro sporti t'i ndajmë nëpër shkolla të ndryshme, kur të hapim klasat sportive. Klasat sportive nuk mund t'i hapë dot një mësues i edukimit fizik, i cili nuk ka mbaruar për atë sport, të cilin ne pretendojmë ta zhvillojmë në klasat sportive. Kjo është një pikë që duhet pare; do një koordinim midis ministrisë, Universitetit të Sporteve e federatave përkatëse.

Për sa i përket një kampionati ballkanik, që u zhvillua dje në Tiranë, është një vërejtje për ministrinë, për strukturat e sportit në këtë ministri, asnjë përfaqësues i ministrisë nuk erdhi në një Ballkaniadë, ku morën pjesë 7 shtete, ku u morën dy medalje ari, si dhe shumë medalje bronzi e argjendi.

Pra, sporte individuale me buxhete mjerane, si sporti i mundjes, nxjerr kampionë Ballkani, duke konkurruar me Bullgarinë, Kroacinë, Maqedoninë, Kosovën, Greqinë në sporte, me sportistë elitarë të niveleve botërore. Sportistët tanë janë në mjerim. Prandaj, unë do të thosha, që të mos marrin shembullin e këtyre sportistëve, si Elvis Guri, që garoi për Bullgarinë, Seit Prizreni që na iku me Australinë në lojërat që u zhvilluan në Brazil.

Kemi një grup sportistësh të talentuar, të cilët kërkojnë buxhete elitare. Prandaj, në Këshillin e Lartë të Sportit, ku është përjashtuar edhe Komiteti Olimpik, që është ombrella e sportit, nuk merr pjesë në atë grup pune, unë mendoj se këto politika të sportit, ky këshill duhet t'i bëjë, duke treguar më shumë vëmendje ndaj këtyre sportistëve elitarë dhe sporteve elitare.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit, zoti deputet!

Patjetër që, kur ju flisni me gjithë pasionin, ne ju dëgjojmë me vëmendje, kështu që do t'i adresojmë me përgjegjshmëri të gjitha kritikët që ju bëtë. Më lejoni t'ju them se nuk është çështje dëshire apo vullneti, ca më pak çështje paaftësie në Ministrinë e Arsimit. Po të doni, ne mund t'ju flasim me shifra e fakte në lidhje me ato që janë bërë për sportin, ashtu sikurse mund të flasim me shifra e fakte edhe për të gjithë programin që lidhet me klasat sportive, patjetër që do të jenë ashtu

sikurse ju thatë. Ka një institut të zhvillimit të arsimit, i cili po ndërton programet, sepse flasim për orë mësimore në një institucion të edukimit parauniversitar.

Në partneritet me Universitetin e Sporteve patjetër, unë vetë kam realizuar disa tryeza të përbashkëta me drejtues të universitetit të sporteve. Ky është një proces që do të vijojë. Patjetër që kemi shumë gjëra për të përmirësuar.

Sa i takon Këshillit Kombëtar të Sportit, besoj se janë njerëz me integritet dhe njerëz që kanë shënjuar standarde dhe cilësi në sport. Në vëmendjen e tyre është gjithçka që lidhet me komponentin e sportit në edukim, e sigurisht, edhe me gjithçka që ju adresuat për sportistët elitarë. Unë dua të them se jo vetëm që investimet në sport kanë qenë më të mëdha, jo vetëm që nuk ka më sportistë elitarë, të cilët nuk e marrin mbrapsht atë që ligji ua njeh si dëmshpërblim, por, sigurisht, ka edhe një vlerë të shtuar, që lidhet edhe me këmbënguljen tuaj personale, në atë që ishte programi ynë për sportin në 2013-ën, me rritjen e numrit të orëve të edukimit fizik, si dhe me funksionimin e dy federatave shumë të rëndësishme të sportit shkollor, parauniversitar dhe i arsimit të lartë.

Tani, këto treguesit që lidhen me mbylljen e lojërave të fatit dhe mungesën e buxhetit, unë jam e gatshme t'ju them këtu, se ai buxhet që shkonte nga lojërat e fatit për te sporti, duhet të ishte dhjetëfish një shpenzim tjetër i buxhetit, që shkonte për të minimizuar efektet që shkaktonin tek të rinjtë e të rejtat prania në lojërat e fatit.

Kësisoj, është e rëndësishme të themi: shumë mirë që u mbyllën. Ky fakt nuk impaktin hiç fare në buxhetin e sportit, sepse ishte një marrëzi kombëtare, e cila ndikonte te fëmijët, që prej moshës dhjetë vjeç, duke i shtyrë të braktisnin shkollën, të bëheshin të dhunshëm, duke shkaktuar sa e sa fenomene të tjera që në momentin kur ndodheshin në bankat e shkollës, pa përmendur se çfarë do mund të ndodhte më pas, kur ata të krijonin familjet e tyre.

Ky është një proces debati, një proces diskutimi. Ashtu siç e tha edhe kryetarja, ne sot jemi vetëm në momentin e parë. Nëse ka hapësira, patjetër që ne mund t'i axhustojmë momente të caktuara që lidhen me buxhetin për rininë dhe sportin. E rëndësishme është që të ecim përpara me tregues e me rezultate, të cilat flasin për një vëmendje të shtuar të qeverisë “Rama” për sportin dhe rininë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Nikolla!

Kolegë, unë mendoj se duhet t'i japim leje përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, që ata të vazhdojnë aktivitetin, sepse ne e përfunduam dëgjuesën me këtë ministri.

Faleminderit shumë dhe aktivitet të mbarë!

Lindita Nikolla – Faleminderit shumë. Mirupafshim!

Milva Ekonomi – Mirupafshim!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 12:10

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për arsimin profesional.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Fatmir Velaj, Vilma Bello, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Dajna Sorensen - Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave,

Gentian Opre - drejtor për buxhetin në MEF,

Silva Banushi - drejtore në MEF,

Stavri Lako - përgjegjës sektori në MEF.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Tani do të dëgjojmë Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave për sa i takon arsimit profesional. Është bashkuar me ne zëvendësministrja Sorensen.

Zonja Dajna, mirë se erdhët!

Ne ia kemi marrë dorën duke ju dëgjuar një çikë si shpesh kohët e fundit, sepse kemi interes të shtuar për arsimin profesional. Do të donim të na thoshit se si e shikoni ju buxhetin e vitit 2019, për të realizuar objektivat që keni në arsimin profesional.

E kemi marrë dokumentacionin që keni sjellë për komisionin. Jemi në dijeni të gjërave, por çfarë mendoni ju se duhet të ndani me ne? Nëse shikoni se ka ndonjë hapësirë për mbështetje dhe kërkonti mbështetjen tonë, na e adresoni.

Dajna Sorensen – Përshëndetje!

Kënaqësi që ndodhem sot këtu, pranë jush, për të raportuar në lidhje me buxhetin e vitit 2019. Ky diskutim i sotëm pason një dëgjese publike, që ne kemi pasur vetëm pak javë më parë, ndaj nuk dua të jem përsëritëse në një pjesë të elementëve që kam prezantuar më parë, kështu që do të ndalem shkurtimisht në arritjet që ne kemi pasur në 2018-ën, në buxhetin e vitit 2018, e do të jap disa *highlights* shumë të shkurtër për sa i përket buxhetit të 2019-ës.

Rëndësinë e arsimit profesional e dimë të gjithë, aq më tepër sa u takon mundësive që ai ofron për të rinjtë, të rejtat dhe personat e të gjitha grupmoshave për t'u integruar në tregun e punës. Në vitin 2018, në këtë vit akademik që përfundoi në qershor, të diplomuarit e arsimit të mesëm profesional përbënë 14, 3 % të të diplomuarve në arsimin e mesëm, një rritje kjo prej 2, 3 % krahasuar me një vit më parë.

Sa i përket pjesëmarrjes në arsimin dhe formimin profesional, kjo pjesëmarrje ka qenë gjithashtu me një trend rritës, që do të thotë se përqindja e atyre që kanë qenë në arsimin profesional, në raport me ata të arsimit të përgjithshëm, u rrit nga 19, 5 % që ishte një vit më parë, në 20, 6 %. Ky trend rritës vazhdon edhe për vitin 2018-2019. Aktualisht, numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale ka arritur në 19 mijë e 296 nxënës, nga të cilët 3102 persona janë vajza. Ky është një element shumë i rëndësishëm, që të kemi rritjen e numrit të vajzave të regjistruara në arsimin dhe formimin profesional.

Për sa u përket regjistrimeve të këtij viti shkollor, pak a shumë interesi vazhdon të jetë në të njëjtat drejtime mësimore, që kane qenë edhe më parë, ku më të kërkuarat janë: hoteleri-turizëm, shërbime mjetesish transporti, teknologji informacioni dhe komunikimi, ekonomi – biznes, elektroteknikë, termohidraulikë, teknologji ushqimore e të tjera.

Një element shumë i rëndësishëm, që do të doja të nënvizoja, është edhe puna e bërë për tërheqjen individëve që u përkasin grupeve në nevojë, përfshirë kryesisht romët egiptianë, personat me aftësi të kufizuara, ata që kanë statusin e jetimit, si dhe ata që janë pjesë e familjeve që jetojnë me ndihmë ekonomike.

Konkretisht, nga 19 mijë nxënës, 527 prej tyre janë romë egiptianë, 115 persona me aftësi të kufizuara, 259 që kanë statusin e jetimit, si dhe 1922 të rinj e të reja, të cilët janë fëmijë të familjeve që jetojnë me ndihmë ekonomike.

Një pjesë e madhe e alokimeve të buxhetit të vitit të kaluar u përdorën për rindërtimin, mobilimin, pajisjen me materiale dhe laboratorët e nevojshëm të nëntë shkollave profesionale. Këtu do të nënvizoja shkollën “Karl Gega” në Tiranë, atë të Kamzës, gjithashtu në Tiranë, shkollën “Ali Myftiu” në Elbasan. “Petro Sota” në Fier. “Kristo Isak” në Berat, “Beqir Çela” në Durrës, “Arben Broci” në Shkodër, hoteleri- turizmi në Tiranë dhe “Gjergji Canco”, që është ndërtim i një shkolle të re. Kjo, realisht do të realizohet në vitin 2019.

Një tjetër element shumë i rëndësishëm për sa u përket arsimit dhe formimit profesional është garantimi i cilësisë në arsimin profesional, ku një nga elementet shumë të rëndësishme është edhe cilësia e mësuesve, instruktorëve që janë të angazhuar në shkollat e arsimit dhe formimit profesional.

Në këto vite është ndërmarrë një proces shumë i rëndësishëm i kualifikimit profesional të mësuesve: 289 mësues dhe instruktorë të AFP-së nga fusha të ndryshme janë trajnuar vetëm në vitin 2018, aktualisht janë në proces trajnimi 114 mësues, deri në fund të vitit ne do të kemi të trajnuar 196 mësues. Ky është një nga indikatorët dhe të mbështetjes sektoriale buxhetore të Bashkimit Europian që nënvizon rëndësinë e kualifikimit profesional të mësuesve.

Gjatë vitit 2018 janë hartuar 10 përshkrime dhe standarde të kualifikimeve profesionale dhe 6 kurrikula kornizë. Po punohet për 3 kualifikime të reja në lidhje me agroturizmin, guidat turistike, shërbimet e hoteleve dhe të restoranteve. Rishikimi i kurrikulave në radhë të parë

synon që të përfshijë ndër të tjera grupe të marginalizuara për të ndjekur arsimin dhe formimin profesional.

Për sa i përket buxhetit të vitit 2019 në lidhje me objektivat madhorë, në radhë të parë programi synon zhvillimin e një sistemi të arsimit dhe formimit profesional, i cili garanton arsim dhe formim profesional gjithëpërfshirës dhe cilësor. Katër janë elementet kryesore që unë do të doja të nënvizoja.

Optimizimi i rrjetit të ofruesve dhe diversifikimi i ofertës së arsimit dhe formimit profesional, rritja e investimeve në arsimin dhe formimin profesional, ngritja e sistemit të kualifikimit dhe të trajnimit të vazhdueshëm që është rritja, përmirësimi dhe forcimi i lidhjeve me biznesin për t'iu përgjigjur nevojave të sektorit privat për forcë pune të kualifikuar.

Objektivat që synohen në programin buxhetor të arsimit të mesëm profesional për periudhën 2019-2021 janë: rritja e aksesit dhe sigurimi i cilësisë. Pra, këto do të ishin dy elementet primare.

Për sa u përket se cilët janë treguesit kryesorë të performancës, do të nënvizoja një pjesë prej tyre, jo domosdoshmërisht të gjitha. Në radhë të parë është përqindja e të punësuarve, të atyre nxënësve që kanë ndjekur arsimin dhe formimin profesional. Kjo ka qenë edhe pjesë e diskutimeve tona gjatë gjithë dëgjësës së mëparshme. Ne synojmë jo vetëm të ofrohet një arsim profesional cilësor brenda ambienteve të shkollave, por mbi të gjitha të sigurojmë që ata të rinj dhe të reja që mbarojnë arsimin profesional të kenë mundësi për t'u integruar në tregun e punës. Këtu një element shumë i rëndësishëm është edhe gjurmueshmëria e këtyre individëve, ne kemi ngritur një sistem të gjurmueshmërisë së tyre.

Lidhur me cilësinë është edhe përqindja e mësuesve të trajnuar me trajnim të vazhdueshëm, është edhe përqindja e të rinjve dhe e të rejave në arsimin profesional krahasuar me arsimin e mesëm të përgjithshëm, sikurse integrimi i grupeve vulnerabël.

Për sa u përket fondeve në terma konkretë, ato të planifikuara në buxhetin e vitit 2018 për arsimin e mesëm profesional janë rritur me 10,7% më shumë krahasuar me vitin 2018. Përqindja që zë buxheti i arsimit profesional në shpenzimet totale për sektorin e arsimit është 6%.

Konkretisht buxheti për vitin 2019 është në masën 3,3 miliardë lekë, që përfaqëson një rritje prej 321, 5 milionë lekësh krahasuar me vitin 2018.

Për sa u përket zërave të shpenzimeve, do të nënvizoja që në shpenzimet korrente të buxhetit janë planifikuar rreth 49, 5 milionë lekë më shumë, një fond i cili është i mjaftueshëm për të zhvilluar politikat ekzistuese, si edhe për të ndërmarrë politika të reja në arsimin profesional. Është planifikuar një rritje buxheti për bursat e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin dhe formimin profesional, gjithmonë me këndvështrimin për të rritur pjesëmarrjen e personave, kryesisht atyre që janë nga zonat rurale apo edhe nga zonat e pambuluara me shërbime të arsimit dhe të formimit profesional për të ngushtuar hendekun gjinor në arsimin dhe formimin profesional.

Është parashikuar dhënia e bursave ndaj vajzave, të cilat ndjekin arsimin profesional në profesione jo tipike të arsimit dhe formimit profesional, ato degë që nuk janë shumë specifike për vajzat në përgjithësi.

Shpenzimet korrente për mallrat dhe shërbimet që do të përdoren për praktikant profesional të nxënësve kanë qenë në rritje.

Për sa u përket shpenzimeve kapitale të parashikuara për vitin 2018 janë planifikuar 820, 7 milionë lekë shpenzime, të cilat do të investohen në ndërtimin dhe rikonstruksionin e 8 shkollave dhe bazave prodhuese të tjera. Gradualisht jemi duke siguruar që pothuajse të gjitha shkollat, 35 shkollat e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri, të mbështeten me financime për rikonstruksionin dhe pajisjen e reparteve të praktikave profesionale.

Unë kam parashtruar edhe një listë të shkollave, të cilat janë parashikuar për rikonstruksion në vitin 2019.

Pak a shumë kjo ishte një tablo e përgjithshme se çfarë është parashikuar në vitin 2019.

Dua të them edhe diçka tjetër, arsimit dhe formimi profesional janë shumë të mbështetur edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Ky është një element shumë i rëndësishëm për t'u nënvizuar dhe një pjesë e diskutimi tonë të brendshëm është si t'i sigurojmë që ato praktika të mira që kemi me mbështetjen e donatorëve t'i ngremë në nivel sistemi, nga këndvështrimi i buxhetit.

Jam e hapur për çfarëdolloj pyetjesh që mund të keni.

Faleminderit!

Milva Ekonomi - Në fakt, dokumenti është shumë i mirë dhe i sqaron të gjitha këto, por është për t'u përgëzuar fakti që ne për vitin 2019 kemi 10,7% më shumë buxhet.

Mua më duket një nga shifrat më të larta të arsimit professional, nëse nuk jam gabim, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo tregon vëmendjen që ka i gjithë programi qeverisës drejt punësimit, se për këtë është e rëndësishme.

Diskutuam edhe herën e kaluar, se janë disa profesione që nuk janë gjinore, por duhet t'u japim akses edhe vajzave. Thamë se ka një drejtim orientues nga qeveria për programe, të cilat nuk kanë ardhur si kërkesë e vetë arsimit profesional, por duke dashur të bëjmë presion pak më sipër, ato mund të jenë më pas orientime të reja profesionale. Ne jemi të gëzuar që shikojmë këtë lloj buxheti për arsimin profesional.

Ka ndonjë pyetje?

Po, zoti Çela. Pastaj zoti Beqiraj.

Bujar Çela – Përshëndes stafin e Ministrisë së Financave për prezantimin dhe optimizmin që parashikohet në vitin 2019 në lidhje me buxhetin e shkollave profesionale!

Ju thatë se është një listë se ku do të investohet në shkollat profesionale. Në rast se është kjo listë, ne duam të njihemi me të, nëse është e mundur.

Ka pasur dhe ka probleme me fasonët, që kanë mungesë specialistësh. Shikojmë se shumë privatë bëjnë nga ato kurset, përfitojnë, abuzojnë, ndoshta janë edhe certifikata jo kompetente, për këto kurse, duke filluar nga kuzhinierë, kamerierë, rrobaqepës, nuk e di, por mund të ketë shumë të tillë, a është parashikuar gjë?

Ka edhe ndërtesa të pashfrytëzuara nëpër shkollat profesionale të trashëguara nga ai sistem. Konviktet kanë kaluar pronë e bashkisë, me sa di unë. Çfarë bëhet për shfrytëzimin e këtyre kapaciteteve? A mund t'u atashohen shkollave, aty ku plotësohen nevojat, si sipërfaqe? Kam parasysh Shkollën Mekanike Bujqësore, të vjetër, në Lushnjë, ku janë shtuar disa profesione, por konvikti në të cilin është investuar disa herë edhe në këtë sistem, është bosh.

Milva Ekonomi – Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Edhe unë jam i kënaqur në aspektin e rritjes dhe të investimeve që do t'i bëhen këtij sektori të rëndësishëm, gati 1-%, sikurse e prezantuat edhe juve, krahasuar me një vit më parë, por kam disa pyetje. Njëra është konstante si pyetje, ka qenë një shqetësim constant, është dhe

mbetet. Më vjen mirë që përfshihen shumë profesione, janë bërë investime, janë bërë shkolla të reja ose janë ristrukturuar ekzistueset, janë mbështetur, është bërë një politikë e drejtë, por kam këtë pyetje: a ka qenë dhe mbetet një nevojë për Ministrinë e Financave mbështetja me profesionistë dhe zhvillimi i sektorit strategjik në Shqipëri në industrinë minerare dhe në sektorin hidrokarbur? Shikoj se janë hapur shkolla vetëm mbi bazën e kërkesës dhe ofertës së tregut, po në këto profesione dhe mbi bazën e kërkesave që ka tregu rajonal dhe ai vendeve perëndimore, kush do të punojë? Është një shqetësim që e kam ngritur në mënyrë konstante dhe nuk shikoj fare asnjë dritë jeshile. Janë bërë investime, shumë mirë, është për t'u përshëndetur, por qoftë edhe investimet që janë bërë në vitin 2018, ku nga 6 shkolla të reja kanë shkuar në 9, së bashku me të rejat dhe të rikonstruktuarat, janë edhe 8 shkolla të tjera të reja në vitin 2019, po për këtë sektor. Unë e ngre zërin me forcë për mbështetjen e industrisë së naftës, që edhe në krizat më të rëndësishme është dhe do të mbetet një nga sektorët strategjikë të rëndësishëm ekonomikë dhe strategjikë, që do të falimentojë vetëm nga mungesa e specialistëve të mesëm dhe të lartë. Ashtu siç u mor nisma që ne t'i stimulojmë, u rrit mesatarja për arsimimin në institucionet e larta të arsimit për mësuesinë, edhe gati 300 ekselentët që u regjistruan, i financon shteti, e ka deklaruar shumë mirë Kryeministri, edhe ky sektor duhet të mbështetet, po ky sektor është një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e kësaj ministrie. Pra, nuk më vjen mirë që nuk ka politika stimuluese, nxitëse për këtë sektor, që është një sektor i vështirë, nuk kërkon njeri të shkojë dhe të punojë në industrinë e naftës, në industrinë e nxjerrjes së mineraleve, por ai duhet të nxitet, të stimulohet.

Më falni për tonin, por e shikoj si një sektor ku ka mbetur vetëm brezi i 55 apo 60-vjeçarëve, që nuk shikojnë reflektim, apo ju, si ministri, që ndani tortën mbeteni pa thërrime, siç thotë populli.

A i quani të drejta shpenzimet për arsimin apo formimin profesional, ku regjistrimet për vitin akademik 2018-2019 janë rritur me 1% krahasuar me një vit më parë? Të them të drejtën mua më vjen mirë që regjistrimi në shkollat profesionale të arsimit të mesëm parauniversitar është rritur me 20,6%. Pra, ky është një numër shumë i konsiderueshëm, por GDP-ja është 0,19% nga 3,3%, që është GDP-ja për mbështetjen e të gjithë sektorit të arsimit. Mua më duket një thërrime kjo gjë dhe më vjen mirë që ju, si ministri përgjegjëse, jeni të kënaqur me këtë sektor.

Milva Ekonomi – Më lejoni t'ju shpjegoj diçka.

Në fakt, shifra e GDP-së të ndihmon të kuptosh se sa zë sektori makro në zhvillimin e përgjithshëm të vendit, por më e rëndësishme është të shikohet se sa është rritur buxheti i atij nënsektori. Në rastin tonë ne kemi një buxhet të rritur të atij nënsektori, madje kjo është ajo që na duhet, kurse të tjerat janë shifra që orientojnë politikat e qeverisë. Për shembull, kur ne themi se duhet ta rrisim buxhetin e arsimit në 5%, sepse e kemi angazhim politik, në fakt, ne e kemi rritur nga viti në vit, sepse nuk mund të shkohet menjëherë në 5%. Këtë vit ne jemi 3,3%, ndërkohë që te buxheti i arsimit nuk është se kemi vendosur një objektiv, por kemi pasur një shifër makro.

Së dyti, e rëndësishme është që ne t'i pyesim përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për sa u takon shpenzimeve që bëhen për arsimin profesional, për degë të veçanta, siç është industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, sepse ky sektor është i privatizuar. Pra, do të ishte mirë që pranë kësaj ndërmarrjeje të kishte një shkollë formimi, ku shteti të kontribuonte në këtë ndërmarrje, sepse të ngresh një industri për të dhënë shembullin didaktik është e vështirë, pasi nuk janë mundësitë. Kështu që presioni që duhet të bëjmë ne nuk është presion për shkollën, por është presion për të ndihmuar në investimin për shkollën që duhet të bëjnë të gjitha entet private që funksionojnë pranë burimeve minerare që kemi në Shqipëri. Unë nuk e di se çfarë opinionit ka stafi profesional, por mendoj se duhet të funksionojë kështu.

Atëherë, le t'i dëgjojmë edhe përfaqësuesit e stafit të ministrisë, në mënyrë që të marrim një përgjigje.

Bujar Çela – Një minutë, zonja kryetare!

Më duket sikur këtyre u bëhet avokati, por unë nuk jam dakord me këtë gjë, sepse jo të gjitha shërbimet janë publike. Pse publike janë të gjitha shërbimet e hotelieri–turizmit?! Pse publike janë të gjitha shërbimet e tjera të fasonerisë?! Pra, nuk qëndron argumenti që shërbimet e privatizuara t'i falimentojmë dhe shërbimet shtetërore publike t'i ndihmojmë.

Milva Ekonomi – Ne duhet të gjejmë formën e ndihmës.

Bujar Çela – Forma e ndihmës është duke hapur me detyrim shkollën profesionale në Mallakastër, në Ballsh, ku shtrihet industria e nxjerrjes dhe e përpunimit të naftës; të hapet shkolla teknike e naftës në Patos, në Berat ose në Kuçovë; të hapen shkollat profesionale aty ku janë minierat: në Mirditë, në Rrëshen, në Burrel, në Kukës dhe kudo, por nuk mund të themi se këto janë të privatizuara. Ky nuk është argument. Po Albpetrol-i që është publik? Pra, nëse do t'u bëjmë avokatinë, atëherë po, por unë nuk shikoj asnjë nxitje, asnjë lloj investimi, sepse ndërtesat janë.

Pra, ato ndërtesa që ka lënë ai para viteve '90, të cilit nuk ia përmendim dot emrin, t'i rregullojmë, se 80% kanë qenë shkolla profesionale.

Milva Ekonomi – A mund të na thoni diçka, si përfaqësuese e ministrisë?

Dajna Sorensen - Dua të bëj disa komente shumë të shkurtra.

Oferta e arsimit dhe e formimit profesional, në radhë të parë, diktohet nga nevojat e tregut, gjithashtu edhe nga preferencat e të rinjve dhe të rejave, që janë të gatshëm ose jo për të shkuar dhe për të studiuar në fusha dhe drejtime të ndryshme. Ne kemi bërë një analizë të nevojave për aftësi dhe kemi identifikuar se ku janë nevojat më të mëdha në ekonominë shqiptare. Domosdoshmërisht sektorët më të mëdhenj që punësojnë shumë në Shqipëri, siç është sektori i turizmit, janë ato që kanë një nevojë shumë më të madhe për një forcë pune të kualifikuar.

Unë e përmenda edhe pak më parë, është shumë e rëndësishme që këta të rinj dhe të reja të bëjnë praktika profesionale në çdo fushë që ata studiojnë. Ne mbetemi të gatshëm që, në qoftë se do të kemi një numër të mjaftueshëm të rinjsh dhe të rejash që janë të interesuar për të ndjekur një degë të caktuar, që nuk ofrohet në arsimin dhe në formimin profesional, për shembull, siç kemi bërë edhe një bisedë lidhur me rastin e Kukësit, ne jemi gati, qoftë me buxhetin tonë të ministrisë, por edhe me mbështetjen e informatorëve, për të hapur një drejtim mësimor aty ky ka kërkesa. Në shumicën e këtyre rasteve, përfshirë rastin e Kukësit, ne nuk kemi pasur një elaborim të nevojave dhe të gatishmërisë për të hapur një sektor të caktuar. Unë jam shumë dakord që sektori privat mund të jetë një nga partnerët tanë dhe ta ofrojnë ata formimin profesional apo kualifikimin profesional pranë vendeve të tyre, siç kemi pasur edhe raste në miniera me “Balfin Group” ku ata kanë hapur një drejtim profesional për t'u shërbyer nevojave të vetë industrisë. Përtej arsimit të mesëm profesional dhe për ato profesione të munguara unë do të doja të nënvizoja, ndoshta edhe ministrja e ka përmendur para meje, se kjo është pjesë e programeve 2-vjeçare, ku disa prej këtyre drejtimeve kanë një potencial edhe më të madh se sa arsimi profesional për t'iu përgjigjur një nevojë të në sektori privat.

Lidhur me përqindjen e buxhetit, besoj se kryetarja e ezauroi tashmë si pyetje.

Për sa u përket pyetjeve që bëri zoti Bujar, mund të them se është e vërtetë që sektori fason është një nga sektorët ku bizneset, në mënyrë të vazhdueshme, thonë se mungon forca e kualifikuar e punës. Në rastin konkret kemi të bëjmë shumë më tepër me një mungesë të vullnetit të punëkërkuesve të papunë për t'u punësuar në këta sektorë, se sa aftësive teknike të munguara.

Në shumicën e rasteve edhe biznesi është i gatshëm për t'iu përgjigjur dhe për ta marrë vetë trajnimin, në mënyrë që këta individë të integrohen në forcat e tyre të punës. Paralelisht me këtë ne po shikojmë edhe për skema specifike incentivuese që gratë, sidomos ato të cilat janë direkt pas lindjes së fëmijëve, për të rikthehen në forcat e punës dhe t'u shërbejnë industrive të ndryshme, përfshirë këtu industritë e fasonerisë.

Ju ishit të saktë për sa i përket pjesës së konvikteve, sepse ato janë në pronësi të bashkisë. Ne kemi eksperiencë nga më të ndryshmet për sa u përket konvikteve, kemi eksperiencë ku nxënësit, sidomos ata të zonave rurale, jetojnë në konvikte, por janë në shkollat të tjera, siç kemi rastin e Lushnjës, por ndoshta zonja Silva mund të shtojë diçka.

Silva Banushi – Siç e tha edhe zëvendësministria, konviktet, përveçse janë pronë e bashkisë, me një VKM kanë edhe destinacionin e përcaktuar për të cilin ushtrojnë aktivitetin e tyre. Ndërkohë, ajo që ministria jonë bën me nxënësit në lidhje me shkollat profesionale është pajisja e nxënësve që vijnë nga zonat rurale me bursa, me të anë të të cilave komplementojnë jetesën e tyre në konvikte, por edhe kjo është në dëshirën e prindërve për t'i çuar ata apo jo në konvikte. Ne jemi duke mundësuar krijimin e konvikteve mësimore (duke marrë shkas edhe nga bashkëpunimi me të dyja bashkitë, të Sarandës dhe të Korçës), të cilat, pavarësisht se janë në pronësi të bashkive, të mund të krijojnë mundësinë që vetë nxënësit të bëjnë praktikat për hotelieri në konviktet ku ata jetojnë. Gjithashtu, dua të them se pjesa e bursave mbetet edhe për këtë vit, ne e kemi shtuar shumë, sipas kërkesave të bashkive nga vijnë nxënësit, sepse kërkesat merren nga bashkitë.

Milva Ekonomi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Atëherë, falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave!

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Faleminderit, zonja Silva dhe stafit tuaj!

Ne duhet të qëndrojmë edhe pak, pasi kemi disa çështje për të diskutuar, që lidhen me aktivitetin tonë gjatë kësaj jave. Atëherë, java jonë do të jetë e zënë me aktivitetin për buxhetin. Dita e nesërme do të jetë më e ngarkuar, krahasuar me ditët e tjera, pasi kemi 3 mbledhje. Në orën 10:00 do të jemi në seancë; në orën 12:30 do të jemi tek takimi informues i ILDKPKI-së për plotësimin e dokumenteve dhe në orën 14:00 do të zhvillojmë një dëgjuesë me ministren e Arsimit, zonjën Nikolla, në këtë sallë.

Në lidhje me takimin informues të ILDKPKI-së, do të trajnohemi për plotësimin e dokumenteve, pasi, siç na u tha, të gjithë i kemi plotësuar keq.

Ditën e mërkurë kemi dëgjesë për buxhetin me Ministrinë e Kulturës dhe me disa institucione të tjera qendrore, siç është Akademia e Shkencave, Akademia e Studimeve Albanologjike...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, do të fillojmë në orën 09:30, sepse ka mbledhje qeverie në orën 11:00.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne kemi dëgjesë, duhet të bëni kuorumin dhe pastaj shkoni në komisionin tjetër. Këtu nuk mund ta fillojmë në orën 10.00, sepse ka mbledhje qeverie...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Ismet, nëse keni planifikuar, atëherë duhet folur me zëvendësuesin, në mënyrë që të plotësohet kuorumi. Duhet të pyesim zotin Baraj dhe zotin Beqaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për të mërkurën, nuk ka mundësi që të fillojmë mbas orës 10.00, sepse ka mbledhje qeverie. Ne do të fillojmë në orën 9.30.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mund të shkoni, sepse edhe ju e dëgjuat nga kryetari i grupit që çdo gjë që keni planifikuar për këtë javë duhet të anulohet dhe do të bëhen vetëm dëgjesat për buxhetin. Tre ministrat u kthyen nga jashtë shtetit.

Unë e kuptoj se çfarë ngarkese keni, sepse i keni dhënë fjalën një grupi njerëzish, më shumë se 60 vetave, por nuk mund të mungoni në komision dhe të shkoni në Shkodër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për këtë javë janë anuluar të gjitha lëvizjet. Të mërkurën mbledhjen do ta lëmë në orën 9:30. Të enjten kemi seancë, ndërsa të premten nga ora 10:00 deri në orën 12:00 do të jemi përsëri këtu për dëgjesa, dhe mbarojmë diskutimin në parim të buxhetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fillojmë të hënën në orën 11:00 dhe pastaj në datën 13 që është e martë.

Fidel Ylli – Të premten ta lëmë pushim, sepse në ditët e javës nuk lëvizim dot, të paktën të kemi të premten dhe të shtunën pushim.

Milva Ekonomi – Dakord, por nuk ia dalim dot, sepse të hënën kemi universitet.

Fidel Ylli – Atë që kemi të premtën ta bëjmë të hënën.

Milva Ekonomi – Të premtën kemi universitetet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Seanca do të jetë e gjatë të enjten.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Doni që të premtën ta bëjmë pushim dhe i mbledhim për të hënën?

Fidel Ylli – Të hënën e bëjmë gjithë ditën.

Milva Ekonomi – Të premtën kemi Radiotelevizionin dhe Qendrën Kombëtare të Kinematografisë.

Fidel Ylli – Lëri për të hënën, mund t'i bëjmë paradite dhe pasdite. Të paktën kemi një fundjavë për të lëvizur.

Muhamet Bela – Një ndërhyrje kam, për të hënën kemi dëgjesa me universitetet publike në orën 11:00 deri në orën 13:00.

Fidel Ylli – Nuk na marrin shumë kohë, sepse do t'u japim kohë të flasin nga 5 minuta.

Muhamet Bela – Unë po jua rikujtoj, dhe mbas orës 13:00 dhe 6 universitete të rretheve.

Milva Ekonomi – Dakord, do ta lëmë të premtën pushim dhe takimet që kemi për të premtën do të spostohen për të hënën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të hënën kemi takim me 12 universitetet, të cilëve do t'u japim 2 orë, pra 11:00 deri në 13:00, pastaj bëjmë pushimin e drekës dhe në 15:00 fillojmë me të tjerët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Muhamet Bela – Universitetet e rretheve janë njoftuar në orën 13:00 dhe do të vijnë 6 rektorë, të cilët do të marrin kohën e tyre, prandaj takimin me Radiotelevizionin ta lëmë në orën 15:00.

Fidel Ylli – Po pra, e lamë në orën 15:00 me Radiotelevizionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Atëherë, takimet e të premtes do t'i lëmë për të mërkurën. Nëse nuk ia dalim t'i bëjmë të gjitha, atëherë do t'i kalojmë të hënën në orën 15:00 dhe të premtën e lëmë pushim.

Fatja kërkon të marrë fjalën për të thënë një lajm, por përpara se të marrë fjalën, unë dua të them se ne, si përfaqësues të Kuvendit, kemi bërë një vizitë të shkëlqyer në Krajova të Rumanisë, ku kemi vendosur bustin e Skënderbeut. I gjithë organizatori i kësaj lëvizje të madhe ishte Fate Velaj, i cili në çdo moment nuk mendoj vetëm si deputet, por edhe si patriot, dhe më shumë si artist, sepse çdo gjë e lidhi me ndjesinë e tij artistike për ngjarjen e madhe të Krajovës. Kjo vizitë u bë në kuadër të 550 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Gjithashtu, dua të falënderoj edhe këshilltarin tonë, studiuesin Muhamet Bela, i cili ka marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare në Prishtinë, ku ka bërë një kumtesë për 550 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut.

Prandaj, sot në komision po prezantojmë dy ngjarje të rëndësishme dhe të dyja me dimensione ndërkombëtare. Fate fjala për ty.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ramë në konsensus, sepse sapo të thashë që i vetmi që ka të drejtë të mungojë në atë orë je ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse do të vish të firmosësh.

Fatmir Velaj – Unë kam një mendim, të cilin jua nisa në grupin që sapo formova “Zosimea grup”. Nisur nga ngjarjet koherente në marrëdhëniet me fqinjët tanë të juglindjes, pra me Greqinë dhe nga biseda që pata në Janinë me deputetin e Gjirokastrës, të cilit i shpreha një mendim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik së bashku me Komisionin e Integritetit Europian të bëjnë një vizitë në gjimnazin “Zosimea” të Janinës, aty ku është arsimuar rilindja kombëtare shqiptare. Duke shkuar atje me një tufë me lule për të respektuar atë gjimnaz, i cili ka qenë si universitet jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Greqinë e asaj kohe, ne respektojmë edhe të gjithë ata djem të Shqipërisë, të cilët i dhanë një ndihmesë shumë të madhe rilindjes kombëtare shqiptare. Gjithashtu, kjo i jep edhe një sinjal qeverisë greke dhe të gjithë forcave greke, duke u thënë se ne jemi një popull që dimë se çfarë do të thotë fjala “faleminderit” dhe që jemi mirënjohës. Nuk jemi thjesht ata që mendojnë ju, por jemi edhe një urë bashkëpunimi mes civilizimeve. Gjithashtu, do të kemi një takim edhe me kryetarin e bashkisë së Janinës dhe krijimin e një dialogu forum me temë “Europa mes meje dhe teje”. Këtë ide e kam parashtruar dhe do ta bisedoj me Kryetarin e Kuvendit, që të vendosë në dispozicion dy furgona që të shkojmë.

Jam i bindur që edhe në Janinë do të bëjmë të njëjtën gjë të bukur që bëmë dhe në Krajova. Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Mos harroni se kemi për të bërë edhe një vizitë në Butrint, por për datat 15-16 më duket pak e vështirë me këtë ngarkesë të buxhetit që kemi, prandaj do ta lëmë në datën 23.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, folëm me Besnik Barajn që të jetë ai si zëvendësues, sepse nuk mund të largoheni më pa zëvendësues në këtë periudhë.

Adelina Rista – Unë dua të them dy fjalë për Faten, i cili me shpirtin e tij prej artisti është kaq kreativ. E falënderoj që në këtë nismë fton të gjithë komisionin për ta bërë pjesë. Unë mendoj që Komisioni i Edukimit dhe Medias duhej të ishte i gjithi në Krajovë për vendosjen e bustit të Skënderbeut dhe jo një pjesë. Fatja si duket ka reflektuar dhe po e fton të gjithë komisionin tonë dhe atë të Integritetit. Fate, suksese në kreativitetin tënd! Unë me ambasadorin e Rumanisë në Fier e vazhdova aktivitetin e nisur nga ju.

Fatmir Velaj – Në Krajovë unë i ftova të gjithë, por ishte një ndërmarrje e madhe, prandaj Kryesia e Kuvendit përzgjodhi disa veta.

Milva Ekonomi – Dakord. Mbledhja mbyllet këtu. Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Fidel Ylli

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ariana Mero

